



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 07.12.2022

Nr: 221

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**EDUKIMIN, INFORMIMIN, NDËRGJEGJËSIMIN SI DHE PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUERE
PËR PJESËMARRJEN NË ZGJEDHJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “g” dhe “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 5, pika 2, shkronjat “f” dhe “g”, të ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”,

V E N D O S:

1. Programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve duhet të ketë pjesë përbërëse të tij të posaçme, edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar.
2. Programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar, përgatitet dhe zhvillohet në bashkëpunim dhe në konsultim edhe me organizatat joqeveritare të cilat përfaqësojnë interesat e këtij grupi.
3. Programi përgatitet dhe zhvillohet për çdo edicion zgjedhor, si për zgjedhje të përgjithshme ashtu edhe për zgjedhje të pjesshme apo për referendume.
4. Programi miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve i paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve draftin e programit për miratim.
5. Materialet edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese, të tilla por pa u kufizuar, si postera,

Data: 07.12.2022 Nr: 221
Ora: 11:00



“Për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin si dhe për krijimin e kushteve lehtësuere për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar”

fletëpalosje, spote radiotelevizivë, duhet të krijohen dhe/ose të përshtaten edhe për zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon aktivitete të posaçme për zgjedhësit me aftësi të kufizuar. Struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, udhëheq punën për zhvillimin e këtyre aktiviteteve dhe sigurohet që ato të jenë publike dhe të hapura.
7. Struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, ka detyrimin t'i dërgojë paraprakisht organizatave që përfaqësojnë zgjedhësit me aftësi të kufizuar, të gjithë projektaktet të lidhura me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve.
8. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon të gjitha lehtësirat e mundshme për zgjedhësit e veçantë për marrjen në kohë nga këta të fundit të çdo informacioni zgjedhor, përfshi këtu edhe aktet e miratuara të KQZ-së, por jo vetëm.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI